

VEPRIMET ME PALËT E LIDHURA

Banka Kombëtare Tregtare publikon në baza tremujore të gjithë tepricat dhe veprimet me palët e lidhura me të, si pjesë e raportimit periodik të Bankës të pasqyrave financiare SNRF.

Informacioni i mëposhtëm me palët e lidhura përbëhet nga Shenimi nr. 13 i raportit të fundit të rishikimit të BKT-së (Banka) sipas SNRF më datë 30 qershor 2020, i nënshkruar nga Grant Thornton sh.p.k. më 21 gusht 2020.

Veprimet me palët e lidhura

Sipas SNK 24 “Palët e lidhura”, një palë e lidhur është çdo njësi që ka aftësinë për të kontrolluar palën tjetër ose të ushtrojë influencë të rëndësishme mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operative.

Identiteti i palëve të lidhura

Banka ka marrëdhënie si palë e lidhur, me aksionarët e saj, njësi të lidhura brenda të njëjtit grup, drejtorët dhe zyrtarët ekzekutivë. Aksionari i vetëm i Bankës është Çalik Finansal Hizmetler, i cili zotërohet nga Çalik Holding në masën 100% në 30 qershor 2020. Pala kontrolluese përfundimtare është Z. Ahmet Calik. ALBtelecom Sh.a., Eagle Mobile Sh.a., Albania Leasing, Aktif Yatırım Bankası A.S. (“Aktifbank”), GAP Pazarlama FZE, Gap İnşaat Yatırımve Dış Ticaret A.Ş., Calik Elektrik Dagıtım A.S dhe Calik Enerji Sanayi Ve. Ticaret A.S, Kompania Kosovare per Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH. A. (KEDS) dhe Kompania Kosovare per Furnizim me Energji Elektrike SH. A. (KESCO) kontrollohen nga Çalik Holding.

Balancat dhe veprimet me palët e lidhura

	30 qershor 2020	31 dhjetor 2019
Aktivet		
<i>Depozita dhe llogarite me bankat:</i>		
Llogaritë rrjedhëse me Aktifbank	270,169	110,864
Depozita me Aktifbank	-	-
<i>Hua dhe paradhënie për klientët:</i>		
ALBtelecom	36,615,474	37,360,984
Albania Leasing	62,072	107,715
<i>Aktive të tjera:</i>		
Të arkëtueshme nga ALBtelecom Sh.a.	43,471	10,170
Totali i aktiveve	36,991,186	37,589,733
<i>Pasivet</i>		
<i>Huamarrje me bankat dhe institucionet financiare:</i>		
Huamarrje me Aktifbank	13,448,220	-
<i>Depozitat e klientëve:</i>		
ALBtelecom Sh.a.	813,073	532,664
Albania Leasing	176,213	285,740
KEDS / KESCO	8,223,148	13,727,846
<i>Other Liabilities:</i>		
Dividend Payable to Calik Finansal Hizmetler A.S.	40,000,000	-
Totali i detyrimeve	62,660,654	14,546,250

	6-mujori mbyllur më 30 qershor 2020	6-mujori mbyllur më 30 qershor 2019
Pasqyra permbledhese e te ardhurave		
<i>Të ardhura të interesit nga:</i>		
KEDS/KESCO	-	5,198
ALBtelecom Sh.a.	898,893	231,962
Albania Leasing	2,059	4,311
Aktifbank	-	1,392,946
<i>Shpenzime interesi për:</i>		
ALBtelecom Sh.a. dhe Eagle Mobile Sh.a.	(133)	(203)
Aktifbank	(337,050)	(1,213)
<i>Tarifa dhe komisione:</i>		
ALBtelecom Sh.a. dhe Eagle Mobile Sh.a.	34,347	30,577
Albania Leasing	1,564	1,772
KEDS / KESCO	23,393	9,446
<i>Letrat e garancisë:</i>		
ALBtelecom Sh.a.	696	1,516
Calik Enerji Sanayi Ve. Ticaret A.S	-	10,192
<i>Të ardhura të tjera:</i>		
Të ardhura nga qeraja operationale nga ALBtelecom Sh.a	30,853	31,551
<i>Shpenzime operative</i>		
ALBtelecom Sh.a., Eagle Mobile Sh.a. dhe Calik Holding	(754,376)	(704,306)
Neto	(99,754)	1,013,749

Tepricat dhe veprimet me drejtorët dhe drejtuesit ekzekutivë

Shpërblimi i drejtorëve dhe drejtuesve ekzekutivë përshihet në shpenzimet e personelit. Detajet paraqiten më poshtë:

	6-mujori mbyllur më 30 qershor 2020	6-mujori mbyllur më 30 qershor 2019
Drejtorët	576,847	112,750
Drejtuesit ekzekutivë	1,182,836	1,680,796
	1,759,683	1,793,546

Shpërblimi i drejtorëve dhe drejtuesve ekzekutivë më 31 dhjetor 2019 ishte 3,940,787 USD.

Më 30 qershor 2020, depozitat totale të drejtorëve prane Bankës ishin 2,203,390 USD (31 dhjetor 2019: 2,142,992 USD), ndërsa teprica e huave të dhëna drejtorëve 175,579 USD (31 dhjetor 2019: 194,078 USD).